



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

### V E N D I M

**Nr. 74, Datë 13/04/2022**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma b), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 54, datë 23.03.2022, e znj. D.R., përfaqësuar nga Qendra T’Reja, ku pretendohet diskriminim, për shkak të moshës, si pasojë e parashikimit të nenit 5/1, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri<sup>2</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Pretendimet sipas subjektit ankues.**

Ankuesja është 67 vjeç, e papunë dhe nuk është e përfshirë në asnjë nga skemat e përfitimit social. Znj. D.R. nuk i plotëson 15 vite të siguruara me pagë minimale për t’u trajtuar me pension pleqërie. Në ankesë pretendohet se për të është shumë e vështirë për t’u punësuar në kompani private, për të siguruar të ardhura për familjen e saj, duke patur parasysh këtu edhe sëmundjet kronike (diabet etj.) nga të cilat ajo vuan. Qendra T’Reja thekson faktin se raste të tilla, si ankuesja D.R. janë identifikuar edhe në qytete të tjera të Shqipërisë.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Në vitin 2014, ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, pësoi disa shtesa dhe ndryshime nëpërmjet ligjit nr. 104/2014 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*”. Një nga shtesat e këtij ligji ishte edhe neni 5/1, ku në paragrafin e parë të tij, parashikohet se: *“Pensionit social është një përfitim që i jepet çdo shtetasi shqiptar, i cili ka mbushur moshën 70 vjeç, është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri, të paktën për 5 vitet e fundit, nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk ka të ardhura ose të ardhurat, që përfiton nga çdo burim tjetër janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social.”*

Për sa më sipër, Qendra T’Reja thekson faktin se referuar moshës së pleqërisë dhe moshës së lindjes të së drejtës për të përfituar pensionin social, ka një ndryshim prej 5 vitesh tek burrat dhe 7.6 vitesh tek gratë. Ndryshimi ka sjellë pasoja negative tek qytetarët, që i përkasin moshës 65-69 vjeç (burrat) dhe 62.5-69 vjeç (gratë), të cilët nuk plotësojnë 15 vite të siguruara me pagë minimale për t’u trajtuar me pension pleqërie, por që mund të kenë 1-14 vite të siguruara. Ndërkohë që në ankesë theksohet fakti se, kjo grupmoshë është e paaftë të sigurojë një vend pune për të garantuar nevojat bazike individuale të jetesës, në kushtet kur një numër i konsiderueshëm prej tyre vuajnë nga sëmundje kronike të moshës. Shumica e qytetarëve të kësaj moshe nuk përfitojnë asnjë lloj mbështetjeje financiare nga shteti dhe janë të destinuar të jetojnë në kushte jo dinjitoze.

Organizata T’Reja kërkon ndërhyrjen e Komisionerit me rekomandim pranë Kuvendit të Shqipërisë, për kryerjen e ndryshimit të nenit 5/1, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, duke ulur kriterin e moshës së përfitimit të pensionit social, të paktën në të njëjtën moshë me atë të pensionit të pleqërisë.

## **II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri**

**Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:**

Ligji nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të *“moshës”* duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile,*

*vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Shoqata T’Reja, në cilësinë e një shoqate me interesa legjitime, përfaqëson znj. D.R., e cila pretendon se diskriminohet për shkak të moshës, nga neni 5/1, i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në bazë të dispozitave të LMD, të ndryshuar, ankesat e depozituara pranë KMD-së shqyrtohen nga ky institucion dhe në përfundim të procedurave hetimore Komisioneri shprehet me vendimmarrje, nëpërmjet së cilës kryesisht konstaton ose jo diskriminimin e pretenduar për një ose disa nga shkaqet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji.

Në rastin konkret, mbështetur në atributet që LMD, i ndryshuar, i jep KMD-së, ky institucion nuk mund të shprehet me vendim mbi pretendime për diskriminim të një individ, një grupi individësh apo grupi vulnerabël, nga dispozitat e një akti ligjor. Në nenin 22, të LMD të ndryshuar, parashikohet se: “Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.” Në kushtet kur, Komisioneri i nënshtrohet akteve ligjore, nuk mundet në asnjë rast të shprehet me vendim, mbi pretendime të subjekteve ankuuese, për dispozita ligjore diskriminuese. Në bazë të nenit 131, pika 1, gërma a), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është Gjykata Kushtetuese, institucioni përgjegjës që vendos për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, ose me marrëveshjet ndërkombëtare.

Në nenin 33, pika 4, gërma b) të LMD, të ndryshuar parashikohet se “Ankesa nuk pranohet kur.... b) ..... është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji. Në rastin konkret, KMD gjykon që ankesa nr. 54/2022 nuk mund të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e LMD, të ndryshuar.

Pavarësisht sa më sipër, në bazë parashikimit të nenit 32, pika 2, gërma ë), të LMD-së, të ndryshuar, ku Komisionerit i njihet e drejta t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues, KMD do të marrë në vlerësim çështjen e hartimit të një rekomandimi për uljen e kriterit të moshës së pensionit social, të paktën në të njëjtën moshë me atë të pensionit të pleqërisë.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 21, pika 1, nenin 22, nenin 32, pika 1, gërma b) dhe pika 2, gërma ë), nenin 33, pika 4, gërma b), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 54, datë 23.03.2022, e znj. D.R., përfaqësuar nga Qendra T'Reja, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha – Të mira dhe shërbime  
Shkak – mosha  
Lloji i vendimit - mospranim